



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U
PRIŠTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr. regj. 37294/11

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDRAVAJTJE NË PRISHTINË, Gjyqtarja Lindita Jakupi me pjesmarrjen e sekretares juridike Iqrame Aliu, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Dragisha Lubisav Krstovic nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 7 Ligjit Nr.04/L-050 për Deklarimin e Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise dhe te Dhuratave te Zyrtareve te larte Publik, e në bazë të nenit 73,74,195 dhe nenit 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 21.02.2011 merr këtë:

A K T V E N D I M

I PANDEHURI: Dragisha Lubisav Krstovic, i lindur më 11.02.1947 ne fsh. Dren/Leposaviq, ku edhe tani jeton në Leposaviq, i martuar baba i tre femijeve, Keshilltar ne Ministrine e Pushtetit Lokal ne Prishtine, i gjendjes mesme ekonomike.

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse më 07.09.2011 si Keshilltar ne Ministrine e Pushtetit Lokal ne Kosove, ka pranuar formularin per Deklarimin e Pasurise dhe kete obligim nuk e permbush brenda afatit ligjor ndaj Agjencionit Kunder Korrupsionit.

Me cka ka kryer kundërvajtje nga 7 të Ligjit Nr.04/L-050 për Deklarimin e Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise dhe te Dhuratave te Zyrtareve te larte Publik.

G J O B I T E T

Me gjobë në shumën prej 500 (pesqinde) €, të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës kur ky aktvendim të merrë formë të prerë, në llogarine e te hyrave gjyqsore KGJK-se nr. 1000430070000518. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë, e njëjta do ti zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 33 ditësh, duke llogaritur 15 (pesëmbëdhjetë) €, për një ditë burgimi. Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të paushallit gjyqsor i pandehuri është i obliguar që të paguaj shumën prej 5 € në afat dhe xhirollogari të njëjtë me gjobën.

Nga një kopje e këtij aktvendimi t'i dorzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencionit Kunder Korrupsionit në Prishtinë, parashtroj kërkesën nr. nr.01-4096 të dt. 24/10/11, për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj Dragisha Lubisav Krstovic, për kundërvajtjen nga neni 7 Ligjit Nr.04/L-050 për Deklarimin e Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise dhe te Dhuratave te Zyrtareve te larte Publik, duke kërkuar që i njëjti të shpallet përgjegjës dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse me marrjen ne pyetje te pandehurit i cili ne mbrojtjen e vet deklaroi se nuk ka plotsuar formulairin sepse i ka dalur nga mendja ky obligim, pasi qe ne kohen kur ishte deputet i Kuvendit te Kosoves ka pasur persona te caktuar te cilet i kane kryer keto sherbime, keshtu qe ne poziten e re si Keshilltar ne Ministrine e Pushtetit Lokal ne Kosove nuk ka ndonje person qe e ndihmon i cili kryen keto sherbime dhe per keta arsye kishte harruar ta permbush kete obligim brenda afatit ligjor.

Në bazë të të dhënave të parashtruara në kërkesë, ndëgjimit të të pandehurit, shiqimit të shkresave të lëndës dhe provave të tjera të administruara gjatë procedurës, gjyqtari në masë të mjaftuar vërtetoi se i pandehuri e ka kryer kundërvajtjen e cila me kërkesë i vihet në barrë, për çka e shpallë fajtor dhe e gjobiti me gjobën e cekur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË / OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U PRIŠTINU / MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA	
Llog. Dep. D.P / DMP	Nr. Pr. 03-388/2012
Nr. i faq. 01	Dat. 31.01.2012
Gj. str. 01	
Nr. post. 01	
PRISHTINA	

Me rastin e shqiptimi të denimit, gjyqtari vlerësoi të gjitha rrethanat nga neni 7 të LMK-së, nën të cilat është kryer kundërvajtja dhe të pandehurit ia shqiptoi këtë lloj denimi, duke llogaritur se edhe me këtë do të arrihet efekti i sanksionimit, që i pandehuri në të ardhmen t'i shmanget kryerjes së veprave të këtilla dhe të ngjashme.

Me sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrojnë ankesë i pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditësh pas marrjes së këtij aktvendimi, nëpërmes kësaj Gjykate dhe pa taksa.

G j y q t a r i
Lindita Jakupi

